USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Meriton Binakaj

Aktivist

Hapat e para të aktiviteteve jashtëshkollore për mua kanë filluar në vitin 2019 me qendrën Handikos në Gjakovë. Pasi që kjo organizatë bazon aktivitetin e saj te kategoria e shoqërisë me nevoja të veçanta, angazhimi im këtu fillimisht ka qenë si pjesëmarrës në takimet dhe aktivitetet e kësaj organizate. Në prill të vitit 2019, për herë të parë u bëra pjesë e grupit punues të UP Shift, që financohej dhe zbatohej nga UNICEF-i në Kosovë dhe Ipko Foundation. Kam marrë pjesë në projektin "Për Ty", ku arritëm të prodhonim produkte të punuara nga vetë personat me nevoja të veçanta dhe 50% e shumës së fituar shkonte direkt te personi që kishte krijuar produktin. Në ngjarjen "Youth Activate Talks" u përzgjodhëm si "Youth Speakers" për inspirimin e të rinjve për t'u bërë pjesë aktive e shoqërisë. Si grup vazhduam tutje bashkëpunimin me Start UP, program ky i cili financohej dhe zbatohej nga Innovation Center Kosova (ICK) dhe UNICEF-i në Kosovë. Vlen të theksohet që e gjithë puna është bërë në baza vullnetare, element i cili u vlerësua lartë nga donatorët dhe bashkëpunëtorët tanë.

Duke pasur parasysh aktivitetet e mia në baza vullnetare, jam përzgjedhur edhe si folës për Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, ku si person me nevoja të veçanta fola rreth ndikimit pozitiv të punës vullnetare në shoqëri. Për mua ishte tejet e lehtë që ta përçoja mesazhin e duhur te të rinjtë e tjerë për arsye se kontributi im vullnetar jo vetëm që nuk kishte munguar, por po rritej dita ditës. Mesazhi im ishte "Nëse unë si person me nevoja të veçanta mund të kontribuoj vullnetarisht për të mirën e komunitetit tim, imagjinoni se çfarë mund të bëni ju të tjerët." Jam i bindur se kam inspiruar shumë të rinj që ta japin maksimumin e tyre përmes kontributit të punës vullnetare në komunitetet e tyre.

Angazhimi im do të mbetet gjithmonë drejt fuqizimit të të gjithë të rinjëve në Kosovë, pa marrë parasysh pozitën e tyre në shoqëri.

#dikurjashehhajrin #hajri #jashehhajrin

Iniciativa "Dikur ja sheh hajrin" në Gjakovë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.